



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0458

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Agon Ramadani - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së OE "Company Zuka Commerce" Sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i Lumenjëve dhe prockave" me numër të prokurimit 651-23-3059-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL GJILAN, më 01/11/2023, mori këtë:

Vendim

- 1. Aprovohet pjesërisht**, si e bazuar ankesa e "Company Zuka Commerce" Sh.p.k. me nr. 2023/0458, e datës 03/07/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i Lumenjëve dhe prockave", me numër të prokurimit 651-23-3059-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL - GJILAN, ndërsa mbetet ne fuqi vendimi i AK.
2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Kuvendi Komunal Gjilan në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 31.03.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë - B05, për aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i Lumenjëve dhe prockave", me numër të prokurimit 651-23-3059-2-2-1.

Ndërsa me datë 12.06.2023 AK - Kuvendi Komunal Gjilan ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin njoftim shpërblen OE K.N.T.SH Teuta – M sh.p.k.

Me datën 16.06.2023 OE "Company Zuka Commerce" Sh.p.k ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek AK - Kuvendi Komunal Gjilan. Ndërsa me datën 22.06.2023 AK –Kuvendi Komunal Gjilan ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Operatori ekonomik ankues i pakënaqur me Vendimin e AK-së, me datë 03.07.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër protokollit 458/23.

Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës - shërbime, vlera e parashikuar e kontratës 100,000.00 €.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtror ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105 të LPP.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me datë 09.07.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar,
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër është pranuar nga gjitha palët. AK pajtohet me rekomandimin e ekspertit ndërsa Operatori ekonomik nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit.

- Seanca dëgjimore -

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtruesat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

-Mendimi i ekspertit shqyrtues-

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja e ka trajtuar sqarimin e çmimeve në përputhje me Rregullat për tenderët jo-normalisht të ulët dhe ka konstatuar se përgjigja “ne kemi gypa rezerve” nuk është i mjaftueshëm dhe nuk i plotëson kërkesat ligjore të LPP-së neni 61 paragrafi 1, 1.1, 1.2 dhe 1.3 rrjedhimisht është në diskrecion të AK-se të vlerësojë se nuk i plotëson kështu që

eksperti shqyrtues konstaton se trajtimi i ofertës së OE ankues është bërë në përputhje me LPP-ne dhe RRPP 001/2022.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin shqyrtues dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të OE ankues nuk kanë përmbajtur argumente, fakte, të gjetura në relacion me çmimet e ofertuara ashtu siç përcaktohet me nenin 61 të LPP-së, të gjitha këto në peshë mjaftueshme që të detyrojnë Panelin që lëndën ta kthejë në rivlerësim, megjithatë legjislacioni në fuqi i referohet AK-së si përgjegjës dhe i jep ushtrimin e diskrecionit që të bindet me ofertat dhe çmimet jo-të tregut andaj edhe sqarimet e dhëna nga OE ankues kanë qenë jo-bindëse për AK-në, ndërsa nga ana e panelit konsiderohet se OE ankues në këtë rast nuk ka ofruar argumente bindëse që do të ndryshonin vendimin e AK-së e poashtu rekomandimin e ekspertit shqyrtues, andaj duke u bazuar nga të gjitha si që u thanë si më sipër është vendosur sikurse në dispozitiv që ankesa të aprovohet pjesërisht, për faktin se parimisht në aspektin procedural OE ankues ka dhënë përgjigjet në kërkesën për sqarime të AK-së duke deklaruar që pozicionet e kërkuara do të plotësoheshin pa hezitim me kërkesë të AK-së, megjithatë nuk është arritur që të vërtetohet se të njëjtat kanë qenë çmime të tregut, gjithashtu këto argumentime nuk kanë qenë të mjaftueshme, bindëse si dhe konkrete që do të orientonin drejt një vendim-marrje në mënyrë tjetër.

Prandaj duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - "Company Zuka Commerce" Sh.p.k.**
- Arkivës së OSHP-së: